

SI TË MERRESH ME VËSHIRËSITË?

Gjashtë Hapat e Besimit (5)

Çdo njeri kalon vështirësi në jetë. Para disa javësh shiko se çfarë më ndodhi. Na rridhte ujë tek kuzhina, lavamani. Mora dikë për ta rregulluar. Nuk kishim çelsa vetëm pinca kaçavida. E mbyllem rubinetin e madh tek korridorin e pallatit, që të punonte ai personi, e hapi e pa, ishte konsumuar gomina. Shkuam blemë gominën, erdhëm sërish; sa e vuri gominën e re, rridhte prapë. “*Do shkojmë të marrim një tubë*” - tha ai personi – “*se qenka dëmtuar dhe tubi*”. Shkuam, morëm tubin, e vumë dhe kur po hapja ujin tek rubineti kryesor, m’u këput rubineti gati në fund dhe s’kapej më me pinca. Në shtëpi s’kishim ujë, shkuam morëm një sharrë hekuri që t’i bënim një kanal të futnim kaçavidën, por rubineti u këput më keq, sa nuk kishe fare si me e kap më. Unë çohem dhe u mbështeta në mur, ndez me shpatull dritën e korridorit, në moment u dogj llampa, shkova të blej një llampë. Kur po hiqja llampën, u këput brenda një pjesë e llampës. Se mbaj mend se çfarë u thye një gjë tjetër në kuzhinë.

Ada, nusja ime tha: “*mos prek asgjë se çfarë të prekësh ti sot u thyeka*”. Unë po qeshja dhe thashë: “*Zot, çfarë është kjo?*”; dukej sikur dilte një problem pas një problemi. Dukej sikur Zoti po luante me nervat e mia.

A të ka ndodh ndonjëherë ty kështu, kur të lëshohen problemet njëra pas tjetrës?

Tek Hapat e Besimit, së pari Perëndia të jep ty një ëndërr se çfarë do Ai që të bësh me jetën tënde. Pastaj, vjen momenti kur t’i duhet të vendosësh për t’i shkuar pas kësaj ëndrre. Hapi tre, vonesat e pashmangshme. Pastaj Hapi katër, Vështirësitë. Disa nga ju mund të jenë në këtë hap në jetë, në Hapin e Vështirësive.

Jezusi pati thënë që kjo gjë do të ndodhte te **Gjoni 16:33** (Ai tha:) “*...në botë do të keni mundime, por merrni zemër, unë e munda botën!*”

Ti, ose sapo i ke kaluar ca vështirësi, ose je në kohë të vështira tani, ose i ke përpara. Vështirësitë janë pjesë e jetës. Ke për të patur vështirësi në jetë, janë të pashmangshme.

Pak njerëz kanë kaluar vështirësitë që kaloi Pali në jetë. Por, ai kurrë nuk hoqi dorë nga ëndrra e tij. (Pali tha:) “*Në çdo gjë e rekomandojmë (tregojmë) veten tonë si shërbëtorë të Perëndisë në shumë vuajtje, në shtrëngime, në nevoja, në ngushtica...me durim*”²

Korintasve 6:4.

Se çfarë lloj besimtari je, tregohet duke të parë sesi reagon ndaj problemeve.

Dëshmia e vërtetë sesa i pjekur je shpirtërisht dhe emocionalisht, tregohet duke të parë ty sesi reagon ndaj vështirësive.

Nëse e dredhon muhabetin, ankohesh, je gërricës, ia mbath nga vështirësitë - nuk je dhe aq i pjekur si person, as shpirtërisht as emocionalisht.

Por, nëse mëson nga vështirësitë atëherë ke për t’u rritur gjithnjë e më shumë.

Tek **Veprat 27** është një nga shumë historitë e vështira që kaloi Pali në jetë. Atë e arrestuan; tani ai është i burgosur dhe po e transportonin me anije për në Romë. Ai e paralajmëroi kapitenin, “*Mos u nisni në udhëtim, sepse Perëndia më ka thënë që do të ketë*

një stuhi të madhe.” Por ata nuk prisnin dot më. Sa herë që ti ngutesh në jetë ke për t’u gjendur në një stuhi. Ata vendosën që do të lundronin dhe stuhia i zuri mes detit, i cili ua mbyti anijen; dhe ky është gjithë kuptimi i kësaj historie të vështirë.

Nga kjo histori e jetës së Palit ne mësojmë 3 gjëra kyçe sesi të merremi me vështirësitë. Disa nga ju, u është “mbytur anija” emocionalisht. Ti nuk ke më pikë energjie.

Disa nga ju, u është “mbytur anija” e shoqërisë, një shoqëri që ty të është dukur shumë e besueshme, por je shumë i zhgënjyer nga të gjithë.

Disa nga ju keni patur “mbytje” financiare apo shëndet të “mbytur”.

Si reagon ti, kur ndodhesh me vështirësi të tilla në jetë?

1. Gjej Arsyen. Pyete Vetën: *“Çfarë e shkaktoi këtë gjë?”*

2. Gjej Rezultatit. Pyet Vetën: *“Çfarë do të më mësojë Perëndia nga kjo vështirësi me të cilën po përballemi?”*

3. Gjej Cili është Reagimi i duhur? Pyet Vetën: *“Si duhet të sillem? Si do Perëndia që të reagoj në këtë situatë që jam tani?”*

I. GJEJ ARSYEN -- “Çfarë e Shkaktoi Këtë Gjë?”

Vështirësitë në jetë ndodhin vetëm nga këto katër shkaqe.

1. Unë jam shkaktoi i shumë vështirësive në jetën time. Shumicën e problemeve ia sjell vetë vetes.

2. Njerëzit e tjerë përreth, që kam kontakt ose jo.

3. Djalli, i ligu.

4. Perëndia gjithashtu mund të jetë shkak i vështirësive në jetën tonë. Ai i lejon problemet që të vijnë në jetën tonë, për të na tërhequr vëmendjen, për të na provuar, për të na forcuar karakterin dhe për shumë arsye të tjera.

Kur unë jam duke kaluar nëpër një situatë të vështirë, nga do ta marr vesh se cili nga këta është shkak? Lutu për këtë gjë, bisedo me Perëndinë për këtë *“Atëherë kërkova ta kuptoj këtë gjë, por ajo mu duk shumë e vështirë. Deri sa hyra në Shenjtoren e Perëndisë...”*

Psalmi 73:16-17

Kur vjen në shërbesën e adhurimit, Perëndia përdor besimtarët e tjerë për të të ndihmuar t’i sqarosh gjërat që po të ndodhin në jetë.

Prandaj unë nuk rri dot pa shkuar në kishë çdo të diel. Mbaj mend kur isha në fshat dhe më duhej të vija në Tiranë për ndonjë dasmë apo gjëra të tilla, unë nuk rrija dot pa shkuar në ndonjë kishë. Nuk shkoj në kishë sepse më rëndon faji, apo që më është bërë zakon, apo se më shtyn dikush. Por shkoj sepse dua të gjej, çfarë do të më thotë Perëndia mua atë ditë? Gati të gjitha vendimet e mëdha në jetën time - shumicën prej tyre - unë i kam marrë të dielave gjatë shërbesës ose pas shërbesës, në kohën e përkushtimeve, në kohën e lutjes. Kur kapiteni dhe timonieri vendosën për të lundruar në Detin Mesdhe, Pali u tha atyre: *“Mos lundroni sepse shpejt do të ketë një stuhi”*, ata bënë tre gabime të zakonshme. Janë tre gabimet më të shpeshta që tentojmë të bëjmë dhe ne, vendime që na fusin në telashe.

1. Dëgjojmë këshillat e gabuara. “...kishte besim më shumë tek timonieri dhe kapiteni i anijes...” (v. 11) Perëndia kishte thënë mos. Pali i paralajmëroi. Por, për shkak se “eksperti” tha “Po”, ata lundruan. Në botë ka shumë ekspertë. Në çdo emision TV ka ekspertë. Ata thonë lloj lloj gjërash, në lidhje me një politikën, jetën, analizojnë atë që po ndodh atë që do të ndodhë. Nëse Perëndia të kërkon ty për të bërë diçka, dhe të gjithë ekspertët e botës të thonë të kundërtën, mos i dëgjo ata. Dëgjo se çfarë të thotë Perëndia.

2. Ne ndjekim Turmën. “... shumica që e mendimit që të lundronim prej andej...” (v.12). Në Anije kishte 276 njerëz. Votimi për të lundruar ishte 273 me 3. Shumica gabon shpesh. Një shprehje që dëgjojmë shpesh është “por të gjithë kështu bëjnë.” E po pastaj? Të gjithë mund ta kenë gabim. Tek historia e popullit të Izraelit kur dolën nga Egjipti për të shkuar në Tokën E Premtuar, shumica donte që të kthehej mbrapa në Egjipt. Shumica e kishte gabim. Mos e bazo mënyrën tënde të jetës sipas drejtimit të shumicës.

Detyrimi, shtytja, presioni nga të tjerët i mban shumë njerëz larg asaj që do Perëndia nga ata. Detyrimi i çon njerëzit në probleme të ndryshme.

Dëgjoni si ka thënë një pastor: “Ne po bëhemi më materialist se ç’kemi qenë. Pse? Se ne blemë gjëra që s’kemi nevojë, me lekë që nuk i kemi, për t’u lënë përshtypje njerëzve që as nuk i pëlqejnë; thjesht që t’u tregojmë atyre që dhe ne jemi të kohës.”

3. Ne mbeshetemi te rrethanat. “Kur filloi të fryjë juga (era e jugut), duke menduar se mund të realizohej qëllimi i tyre, i ngritën spirancat dhe filluan të lundrojnë...” (v. 13). Ata menduan që është një ditë e mirë për të lundruar. Pali u tha: “jo, mos lundroni po shkojmë drejt stuhisë.” Por, ata vazhduan dhe përfunduan në mbytje të anijes. Satani mund t’i rregullojë rrethanat. Mos shko pas çdo mundësie që të krijohet. Mos shko pas çdo dëre që të hapet. Mos prano çdo lloj pune dhe mundësie që del. Mos dil për kafe me çdo gocë, apo çun që të jepet mundësia. Por, ti duhet t’i kërkoksh Perëndisë nëse kjo është ajo që Perëndia do që të bësh apo jo. Mos vendos, sepse të duken rrethana të favorshme—dukej mirë për ta që të lundronin në oqean të hapur. Por, Perëndia tashmë kishte thënë jo, dhe ata po i shkonin furtunës ballë për ballë, sepse mendonin që po bënin gjënë e duhur.

Vështirësia më e madhe për t’u marrë është kur ti ke rënë viktimë e një situate dhe nuk është faji yt që je aty. Është një problem që nuk ia solle ti vetes por ama ndodhesh në një situatë të vështirë. Në situatën e Palit, Ai u kishte thënë atyre: “Perëndia thotë mos e bëni këtë gjë ose do të mbytet anija.” Ata nuk e dëgjuan por u nisën, Pali ishte i burgosur dhe duhet të lundronte me ta. Ai përjetoi mbytjen e anijes për shkak të njerëzve të tjerë.

Në jetë, jo të gjitha “mbytjet e anijeve” janë faji yt. Disa prej tyre ti i përjetove sepse ishe në vendin e gabuar në kohën e gabuar.

Këto janë situatat më të vështira. Ty po të ndodh diçka vetëm sepse ti ishte aty.

II. GJEJ REZULTATIN

Pyete Vetën: “Çfarë do Perëndia që të mësoj nga kjo vështirësi?”

“Sepse trishtimi ynë i lehtë që është vetëm për një moment, prodhon për ne një peshë të pamasë e të pashoqe të amshueshme lavdie.” 2 Korintasve 4:17

Pali po thotë që problemet që kemi në jetë nuk do të zgjasin. Janë të përkohshme por shpërblimi është i përhershëm. Qëllimi është i qëndrueshëm, i përhershëm.

Kur kalojmë nëpër vështirësi, gjëja e parë që bëjmë është ua vëmë fajin të tjerëve.

Por i kujt është faji? Nuk është puna se nga erdhi problemi, Perëndia ka përsëri një qëllim për atë situatë. Ai do që ti të forcohesh në karakter, si pasojë e asaj që po kalon.

Madje, edhe kur ti bën gjëra koti vetë, budallallëqe, Perëndia i përdor edhe ato.

Madje edhe kur të tjerët të lëndojnë me qëllim Ai e përdor edhe këto gjëra.

Dhe kur djalli planifikon gjëra të këqija për jetën tënde, Perëndia nxjerr të mirën nga ato.

Qëllimi i Perëndisë është më i madh se problemi apo dhimbja jote. Perëndia ka një plan pas çdo dhimbje, problemi që ke, dhe Ai do ta përdorë atë që po kalon.

Ti duhet të shikosh përtej dhimbjes së përkohshme dhe shiko në afat të gjatë, përfitimet, rezultatet që do të sjellë në jetë ajo që po kalon ti. *“Mburremi edhe në shtrëngimet, duke ditur që shtrëngimi prodhon (na mëson) këmbënguljen, këmbëngulja përvojën dhe përvoja shpresën.” Romakëve 5:3-4*

Po rezultati? Perëndia do që të mësosh diçka. Ky është qëllimi i problemit dhe vështirësive që po kalon. Çdo stuhi në shkollë. Çdo sprovë. Perëndia do që të mësojë diçka nga shqetësimet e tua. Çdo përvojë është mësim. Çdo vështirësi është për rritjes tënde. Perëndia thotë, unë dua që ti të mësosh diçka nga kjo vështirësi—ky është qëllimi, rezultati përfundimtar.

Shumica nga ne mësojnë shumë ngadalë. Shumica nga ne mësojnë diçka pasi kaluar nëpër një situatë më shumë se një herë. Nëse ti nuk mëson nga ajo që kalove, Perëndia ka për ta sjellë përsëri në jetën tënde të njëjtën gjë. Do të kthehet. Sepse Perëndia është më shumë i interesuar tek karakteri yt sesa tek rehatia jote. Perëndia është më shumë i interesuar të bëjë ty si Krishti sesa t’i bëjë gjëra e lehta për Ty. Asnjëri nuk kalon gjithë shkollën apo punën apo ditën, javën, muajin pa asnjë vështirësi. Perëndia i lejon ato.

Disa nga ju mund të jeni duke u përballuar më një vështirësi tani. Mund të jetë shëndetësore dhe ti nuk ndihesh mirë. Apo ndonjë lloj frike, apo fajësimi apo problemi financiar, apo lodhje, bezdisje në shoqëri. Disa nga ju mund të kenë patur një *“mbytje anije”* këtë mëngjes. A ka diçka për të thënë Perëndia ty, nëse ti je duke kaluar një kohë të vështirë? Sigurisht. Perëndia të ka sjellë ty këtë mëngjes që të thotë: *“Mos u dorëzo, por Rritu, forcohu në karakter.”* Kjo është ajo që do të arrijë Perëndia me anë të asaj vështirësie që po kalon ose do të kalosh. Ai nuk do që ti të dorëzohesh, Ai do që të rritesh. Ai do që ti të piqesh, forcohesh, të bëhesh sa më shumë si Ai.

Si mund ti përdorësh vështirësitë dhe problemet që të rritem? Duke bërë këto tre gjëra. Gjej arsyen, Gjej rezultatin, Gjej reagimin.

III. GJEJ REAGIMIN

Si duhet të përballem me këtë? Si duhet të reagoj? Si duhet të përgjigjem? Ti ke për t'u lënduar në jetë shumë, shumë herë sepse jeta nuk është e drejtë. Thjesht nuk është e drejtë. Ke për të patur probleme, vështirësi dhe lëndime që do të bëjnë ty të hidhur, në disa momente edhe më keq. Ti ose do të dorëzohesh ose do të forcohesh. Ti ose do të bëhesh ashtu siç do Perëndia të bëhesh ose ke për t'u rrudhur dhe zemra jote ka për t'u ngurtësuar. Është zgjedhja jote. Kur ti kalon nëpër këto situata në jetë, këto kohë të vështira, e rëndësishme nuk është ajo që po të ndodh ty, por ajo që po ndodh brenda teje. Situatat që të ndodhin në jetë nuk janë aq të rëndësishme sa ajo që ndodh brenda teje. Sepse ajo që ndodh brenda është ajo gjë që do të jetë me ty në përjetësi. Jo rrethanat, se ato janë të përkohshme. Por ai që do ta kesh gjithmonë do të jetë karakteri yt, karakteri është bërë ashtu siç të kanë bërë situatat e jetës—të mirë, të fortë ose të hidhur. Si duhet të reagoj unë ndaj situatave të vështira?

Tek **Veprat 27** mësojmë tre gjëra që nuk duhet të bëjmë. Këto janë gjërat tipike, që ne tentojmë kur kalojmë nëpër vështirësi.

1. Vështirësitë mund të shtyjnë të ndryshosh drejtimin. “...e lamë (anijen) në mëshirë të fatit dhe kështu filluan të shkojmë sa andej-këtej.” (v. 15) Anija që po çonte të burgosurit në Romë ishte në mes të detit Mesdhe, nuk e kishin parë diellin për 14 ditë, errësirë e plotë. Nuk po e përballonin dot më, nuk i shikonin dot yjet, nuk e kishin idenë fare se ku ishin. “...e lanë (anijen) në mëshirë të fatit” hoqëm dorë për të lundruar në ndonjë lloj drejtimi, dhe e lamë anijet të ikte nga t'i donte qejfi.

Kjo është ajo që të sjell problemi, nëse nuk je i kujdesshëm. Disa njerëz fillojnë dhe e lënë jetën pa drejtim. Nuk kanë asnjë qëllim në jetë, asnjë synim, asnjë ambicie, asnjë ëndërr për jetën. Ata thjesht ikin pa drejtim me turmën, nga të shkojë jeta, nga ti marrë era. “Jeta është e vështirë, kështu që përse të sforcohem më shumë? Përse të lodhem kot? Unë do të bëj gjërat më minimale në jetë.”

Sot, ne nuk e quajmë jetë pa drejtim, por e quajmë jetë e lëshuar. Problemi me lëshimin është që ti je drejtuar kokë-poshtë. Drejtimi yt nuk shkon kurrë lart, vetëm poshtë. Nëse po jeton një jetë të lëshuar, je në drejtim të gabuar. Jeta nuk është - “jetë varja”, “dali ku të dali”- sepse do dali vetëm për keq, për poshtë. Jeta është e vështirë. Mos hiq dorë nga synimi yt, ambicia jote, ëndrra jote vetëm për shkak se jeta bëhet e vështirë.

2. Mos hiq dorë. “... filluan ta hedhin në det ngarkesën.” (v.18) Ata janë në mes të Detit Mesdhe kanë kaluar 14 ditë pa diell. Janë të rraskapitur nga era dhe lëkundjet e dallgëve para—mbrapa. Dhe tani, po hedhin ngarkesën në det për ta lehtësuar anijen. Në fillim ngarkesën, pastaj mjetet e anijes, pastaj ushqimin. Ishin gati të hidhnin të burgosurit në det. Ata po hidhnin çdo gjë, po hiqnin dorë nga gjërat që ishin të nevojshme sepse stuhia ishte shumë e fortë. Ky është reagim i natyrshëm kur njerëzit ndodhen para vështirësive. Kur ti ndodhesh në një furtunë, një vështirësi, një sprovë, kur acarohesh aty ku s'mban më, dhe presioni nga të tjerët rritet, stresi bëhet i padurueshëm, ke tendencën për të hequr dorë nga gjërat, nga standardi yt, miqësitë. Gjëra që nuk do t'i bëje nëse do të

ishe në formë. A i ke dëgjuar këto shprehje?! “S’duroj dot më, më ka ardhë në majë të hundës, jam deri në grykë. Do e lë shkollën, punën, të dashurin/ren, burrin, gruan. Do heq dorë nga ky muhabet. Do iki. Nuk ia vlejtkërka. Do heq dorë nga ëndrra ime, as që e mendoj ta mbaroj shkollën, as që e mendoj të punoj edhe një ditë më me të, as që e mendoj që mund të martohem me atë njeri, as që e mendoj që shtyhet jeta me këtë njeri... kjo s’ka për të funksionuar...ëndrra ime s’do realizohet kurrë.”

Ne fillojmë dhe hedhim gjëra jashtë, gjëra që s’duhen hedhur. Vlerat e jetës, nivelin që kemi, shoqërinë, lidhjen, ulim standardin ose e lëshojmë fare.

Hedhim tutje gjëra që s’duhet ti hedhim. Ndodh pa vetëdije, ne veprojmë të shtyrë menjëherë nga impulsi, momenti.

Perëndia thotë, qëndro me anijen **v.31** “Pali i tha centurionit dhe ushtarëve, ‘po nuk qëndruan këta në anije, ju nuk do të shpëtoni. Dhe ushtarët prenë litarët e varkave shpëtuese dhe i hodhën në det.” Ata hodhën varkat e shpëtimit, që të detyronin çdo njeri të rrinte në anije. A e ke bërë këtë gjë në punë, në shkollë apo familje? A ke thënë, “ikja nuk është mundësi për mua. Unë do ta bëj këtë gjë të funksionojë si duhet, me fuqinë që më jep Perëndia, martesën, këtë lidhje, këtë shoqëri, këtë punë, këtë shkollë.”

A e ke mbyllur derën sekrete të daljes, e ke mbyllur me çelës dhe e ke hedhur çelësin? Ndarja, largimi, ikja nuk janë mundësi. Nëse nuk e ke marrë këtë vendim, largimi është gjithmonë tundimi i radhës: “po sikur ta lë, po sikur të iki, po sikur të heq dorë, po sikur ta ndërpres”. Nëse nuk e hedh atë çelës, nuk ke për t’u rritur në atë masë në karakterin tënd, në masën që Perëndia do që të rritesh.

Është gjithmonë më e lehtë për të hequr dorë, sesa të rritesh në karakter. Perëndia mund të ndryshojë situatat, personalitetin. Ai mund të ndryshojë ty, por Ai nuk të ndryshon dot nëse ti gjithmonë del nga dera e pasme, ia mbath.

Ai të thotë ty, “Rri në anije.” Mos hiq dorë nga standardi që ke, vlerat që di se janë të rëndësishme dhe të duhura. Mos hiq dorë nga gjërat që ke nevojë në jetë. Unë e kam mësuar nga përvoja personale që nuk është vullneti i Perëndisë për mua të iki nga një situatë e vështirë. Nëse ikën, do të duhet të përballësh me të njëjtën situatë përsëri. Sepse Perëndia do që të mësosh, të rritesh, të zhvillohesh. Rri mos ik.

Ndoshta, ti mund të kesh menduar dhe për këtë kishë, që nuk është në nivelin që do të doje ti, nuk po merr gjërat që prisje dhe ti mendon të ikësh, të largohesh, nëse ke qenë duke menduar një gjë të tillë, Perëndia të thotë ty sot, mos ik, por rri.

3. Vështirësitë na dëshpërojnë. “... humbëm tashmë çdo shpresë shpëtimi.” (v. 20)

14 ditë në errësirë të plotë, nuk e dinin se ku po shkonin, madje janë të rraskapitur, i lëkundte era para-mbrapa. Së fundi, ata i hoqën shpresat. Kjo është e fundit që i humb njeriut, Shpresa. Por ata kishin harruar një gjë: Edhe në stuhi, Perëndia është në kontroll. Ai nuk të ka braktisur ty. Ti nuk e ndjen Zotin afër. Nëse ti ndihesh sikur Zoti është i largët, po e gjete kur ka lëvizur? Ai nuk të ka lënë ty. Ai është me ty në atë stuhi.

Ai do të ndihmojë të kalosh nëpër këtë stuhi. Perëndia po e teston besimin tënd për të parë a do ti besosh Atij apo jo. A ke kaluar një, apo disa momente dëshpërimi në jetë? A do të

doje të ndaje me ne një moment nga jeta jote? Unë dua shumë që herë pas here të dëgjojmë dëshmi nga ju sesi Zoti ju ka ndihmuar të kaloni nëpër vështirësitë, sesi Ai i është përgjigjur lutjeve tuaja në ditë nevojë.

Por, cili është **Reagimi i Duhur** ndaj vështirësive? Nëse nuk je në një të tillë, tani ke për t'u përballur me të nesër, ose në ditët që do të vijin, sepse kështu është jeta.

1. **Rrëfej pjesën time.** Nëse ia ke sjellë vetes vështirësitë që po kaloje, atëherë ndalo dhe mos fajëso të tjerët, pranoje pjesën tënde të gabimit. Mos u justifiko. Merru me problemin dhe thuaj, *“Unë ia solla vetë vetes.”*

Nëse ke probleme me pijen, pranoje. Nëse ke probleme me gënjeshtren, thashethemet, pranoje. Nëse ke probleme me durimin pranoje. Nëse ke probleme me gjuhën, pranoje. Nëse ke probleme me vetëkontrollin, pranoje. Bibla thotë: *“Kush i fsheh shkeljet e tij nuk do të ketë mbarësi, por ai që i rrëfen dhe i braktis ato, ka për të fituar mëshirën (ka për të fituar një mundësi tjetër).” Fjalët e Urta 28:13*

Pranoje përgjegjësinë. Çfarë është diçka që po hiqesh sikur nuk është problem, që s'ishte për fajin tënd, që nuk ishte ti që ia bëre dëmin vetes?

Së pari, pranoje që ti je problemi dhe ke për të parë që gjërat do të rregullohen, ai që e rrëfen dhe e braktis- pra, ai që e rrëfen, pendohet dhe ndryshon- ka për të fituar një mundësi të re fillimi, një shans të ri. Pa pendesë, pa ndryshim, pa braktisje, nuk ke sesi ta fitosh apo ta gësh mundësinë e re.

2. Ballafaqohu. Bëj aq sa ke mundësi. Shiko se çfarë bëri Pali **27:34-40** *“Prandaj ju këshilloj të hani diçka, sepse kjo është për shpëtimin tuaj, sepse as edhe një fije floku nga kokat tona nuk do të bjerë.”* Kur je i stresuar, i tensionuar, në momente krize, dëshpërimi, vështirësi, kur problemet po ta marrin frymën dhe ti mendon që kaq ishte; ti ia var vetes, nuk kujdesesh më për veten. Nuk ha në mënyrë të rregull, nuk fle aq sa duhet, nuk bën gjërat praktike që bëje më parë.

Pali tha; kur je në dëshpërim, i stresuar mos harro gjërat e thjeshta, si ngrënia në mënyrë të rregullt. Ata kishin 14 ditë të shqetësuar për vdekje dhe nuk kishin ngrënë asgjë. Pastaj ai u tha të bënë disa gjëra të tjera, lehtësuan anije, zgjidhën spirancat, liruan timonin, me qëllim që anije të kalonte stuhinë, duke shkuar përmes saj.

Kjo është mënyra sesi kalohet stuhia, ti nuk ia mbath me vrap. Ti nuk i kalon nga poshtë, as sipër, as përçark. Perëndia nuk do që ti t'i biesh përçark stuhisë. Ai do që të kalosh përmes furtunës së jetës. Mënyra e vetme për t'u përballuar me një stuhi është drejtpërdrejt. Nëse kthehesh anash, do shembesh, do përmbysesh.

Perëndia të thotë: *“Përballu me furtunën, mos ia ki frikën. Shkoi drejt përpara.”*

Problemët nuk zgjidhen duke i injoruar. Perëndia nuk thotë që kur i shkon furtunës përpara ka për të qenë e lehtë. Por Ai thotë: *“Unë do të jem me ty.”* Perëndia nuk po thotë që ajo që po kalon ti tani është e lehtë. Por Ai po të thotë, *“Unë jam me ty.”* Dhe ti, do t'ia dalësh me sukses.

3. Thuaj, shpall një premtim me gojë. Në Bibël ka mbi 7.000 premtime që duhen shpallur kur të kalosh nëpër ditë të vështira. **V.25** “Prandaj, o burra, kini zemër të gëzuar, sepse unë besoj në Perëndinë, se do të ndodhë pikërisht ashtu siç mu tha.”

Perëndia do ti mbaj premtimet. Perëndia nuk tha që anija do t’ia dalë me sukses, por Ai tha që **TI** do t’ia dalësh. Madje Ai tha që anija do të shkallmohet, shkatërrohet. Disa nga ju po kaloni në një stuhi tani. Ndoshta “anija jote” nuk do t’ia dalë me sukses. Ti mund të humbësh vendin e dëshiruar të punës, apo ndonjë dëmtim tjetër rreth e qark teje.

Perëndia nuk na ka premtuar që të gjitha gjërat rreth nesh do të jenë të rehatshme, kushte të mira. Por Ai ka thënë, **TI** do t’ia dalësh me sukses, **v.40b-44** “Pastaj si e ngritën velën kryesore nga era, u drejtuan për te bregu. Por mbasi ranë në një cekëtinë që kishte deti nga të dy anët, anija ngeci dhe mbeti me bashin e zënë e të palëvizshëm, ndërsa kiçi po shkallmohej nga furia e valëve. Ushtarët ishin të mendimit t’i vritnin të burgosurit, që asnjë të mos ikte me not. Por centurioni, duke dashur të shpëtonte Palin, ua largoi mendimin për këtë propozim dhe u dha urdhër atyre që dinin të notonin të hidheshin të parët në det dhe të dilnin në tokë, pastaj të tjerët, kush mbi dërrasa, kush mbi pjesë të anijes; dhe kështu ndodhi që të gjithë mundën të shpëtojnë në tokë.”

Perëndia tha tek **v.22**; “përveç anijes, të tjerët do të shpëtojnë të gjithë”. Dhe ajo u shkallmua copë - copë. Disa nga ju mund të jeni në një stuhi tani. Ty do të duhet të dalësh në breg me një copë dërrase të thyer. E rëndësishme është që do të dalësh në breg.

Asnjë nga ne nuk i ka të gjitha gjërat në jetë të plotësuar, ose në karakter. Ne të gjithë kemi mangësi personale. Por, ke për të dalë në breg me një copë dërrasë të thyer.

TI mund të kesh një zemër të thyer, të lënduar, por do t’ia dalësh.

TI mund të kesh një familje copë-copë, por do t’ia dalësh.

TI mund të jesh në një punë, shkollë, shoqëri copë-copë por **TI** do t’ia dalësh.

Perëndia thotë: “Unë jam me ty.”

A ndihesh i kërcënuar nga një furtunë e jetës? A ndihesh sikur era po të sjell vërdallë? A ndihesh si ajo anija e vogël në mes të Detit Mesdhe dhe nuk ke parë dritën e diellit për 14 ditë? Andihesh sikur po ndahesh në copa, po rraskapitesh, gati për të kapitulluar?

TI nuk di se çfarë të bësh. A ndihesh sikur Vështirësitë po ta vonojnë ëndrrën tënde?

Nëse po, atëherë je në Hapin e Katërt të Besimit.

Çfarë duhet të bësh kur je në Hapin Katër? Mos u dorëzo. Mos të munda ankthi apo frika.

Mos i lejo vështirësitë ta ndryshojnë drejtimin që ke nisur, mos hiq dorë nga ëndrra jote, nga ambicia, synimi i jetës, mos e lësho veten.

Mos hidh tutje standardin tënd, vlerat e tua, gjërat e çmuara, miqësitë, shoqëritë që janë shumë të rëndësishme.

Mos hidh tutje bindjet dhe miqësinë tënde me Perëndinë, mos hiq dorë nga ardhja në kishë, mos hiq dorë nga pjesëmarrja në grupin e vogël, kërko për një grup të tillë, mos hiq dorë nga koha e qetë, koha jote personale me Perëndinë, duke lexuar Biblën dhe biseduar në lutje me Perëndinë.

Mos jeto një jetë të lëshuar, mos e ndrysho drejtimin, mos hiq dorë, mos u dëshpëro.
Mos i humb shpresat.

Gjëja më interesante në të gjithë këtë historinë që pamë bashkë sot është se çdo gjë dhe çdo njeri po shpartallohej nga furtuna, përveç Palit. Përse Pali ishte i qëndrueshëm, përse nuk po “shkallmohet” dhe ai si të tjerët? Sepse besimi i tij nuk ishte tek anija, por tek Perëndia.

Ti po kalon disa furtuna, ca të mëdha ca të vogla.

Nëse unë ia kam sjellë vetes këtë furtunë, gjëja e parë që duhet të bëj është të pendohem—të ndryshoj.

Ta pranoj para Perëndisë mëkatin tim dhe ti kërkoj Atij të më ndihmojë të ndryshoj.

Nëse Satani e ka sjellë atë problem në jetën time, unë duhet t’i rezistoj atij—të përballem në luftën shpirtërore dhe t’i rezistoj asaj që ai do që të bëjë tek unë.

Nëse Perëndia e ka sjellë këtë problem në jetën time, unë duhet të rri i qetë.

Në fakt, unë duhet të rri shumë i qetë, pavarësisht se cili mund të jetë burimi i problemit, dhe ti besoj Perëndisë.

T’i kërkoj Atij, “Perëndia im, çfarë do Ti që të mësoj nga kjo situatë që po kaloj?”

Vendose besimin tek Ai.

Lutje Përkushtimi:

Të përkushtohem që nëse jam apo do të jem para vështirësive do të gjej:

Arsyen - çfarë e shkaktoi këtë vështirësi që po kaloj?

Rezultatin - çfarë do të më mësojë Perëndia nga kjo që po kaloj?

Reagimin - si të reagoj si duhet ndaj kësaj që po kaloj?

Lutje e Shpëtimit:

Jeta është e vështirë, por me Zotin jeta është më e lehtë. A do që t’ia përkushtosh veten Jezus Krishtit, që Ai të jetë Zoti i jetës tënde dhe të ndihmojë çdo ditë, në ditët e mira dhe të vështira?